



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljenen/Prodato Received/Delivery	04.07.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Org./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/ARK	5006/2023		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr 392/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses ka shqyrtuar e ankesën A.nr.392/2021, të datës 06.05.2021 të parashtruar nga ankuesi _____ me adrese banimi Rr. _____

Prishtinë, kundër organit të punësimit/ Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, në çeshtjen juridike "kërkese nga marrëdhënia punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr.03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 04.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.392/2020 e datës 06.05.2021, e parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, me datën 06.05.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2254/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 26.04.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se i njëjti është duke u diskriminuar nga institucionin punëdhënës ngase nuk paguhet për punën e bërë, me kërkesën për rimbursimin e diferencës në pagë në mënyrë retroaktive prej datës kur ankuesi ka filluar t'i kryej detyrat shtesë për pozitën e Zyrtarit të Pranimit të Mallit/Logjistikes, si dhe të bëhet ndryshimi i akt-emërimit në përputhje me përkrahimin e detyrave të punës, të cilën e ushtron që nga vitin 2010.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.05.2021 ka procedura kërkesën për përgjigjen në ankesë, ndërsa kjo e fundit me datë 17.05.2021 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mungesë të kuorumit për vendosje nuk ka shqyrtuar ankesën e ankuesit, ndërsa ankuesit më datë 06.07.2021 është njoftuar për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, duke e udhëzuar që pala mund të fillon konfliktin administrativ në pajtim me Ligjin për Konfliktet Administrative, kështu që ankuesi ka vazhduar me hapjen e konfliktit në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 25.05.2023 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.1756/2021 me të cilin ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën A.nr.392/2021 të datës 06.05.2021 të parashtruar nga ankuesi Lumni Parduzi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me e numër të protokollit 2254/2021 të datës 06.05.2021 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Aktin e Emërimit të datës 15.07.2012 si dhe përshkrimi i detyrave të punës së ankuesit; Vendimin e datës 19.10.2010; Certifikatën e datës 08.09.2010 me të cilën vërtetohet se ankuesi ka përfunduar me sukses trajnimin "Moduli i Blerjeve Zyrtari i Pranimit të Mallit"; Autorizimin për qasje në SIMFK të datës 06.10.2010; Kërkesën për qasje të përdoruesve të datës 06.10.2010; Kërkesën e datës 13.04.2016 Ref AACK/ADM/BNJ/28 të parashtruar nga ankuesi tek Drejtori i Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore; Kërkesën e datës 29.04.2016 Ref; AACK/ADM/BNJ/28 për ndryshimin e emërimit të pozitës të parashtruar nga ankuesi tek U.d. Drejtori i Departamentit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore; Kërkesën e datës 23.09.2016 Ref; AACK/ADM/BNJ/28 për ndryshimin e emërimit të pozitës të parashtruar nga ankuesi tek Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Letrën përcjellëse të datës 29.04.2016; Kërkesën e datës 24.03.2021 me numër 2021/ADM/98 të parashtruar nga ankuesi tek Drejtori i Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil; Njoftimin e datës 26.04.2021 me numër të protokollit 2021/ZDP/143 të Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil; Certifikatën e datës 08.08.2019 me numër; 110/2019; Certifikatën e datës 16.11.2012 me numër 241/2012; Certifikatën e datës 18.12.2018 me numër 18/PPDL-0117; Certifikata Plotësuese; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 12.05.2021 me numër të protokollit 2366/2021; Përgjigja në ankesë e datës 17.05.2021 me numër të protokollit 2021/BNJ/161; Akt Emërimit të datës 15.07.2012 si dhe përshkrimin e datës të ankuesit Lumni Parduzi; Vendimin e datës 19.10.2010 me numër REF 12/2010; Njoftimin me numër të protokollit 3480/2021 të datës 06.07.2021, Aktgjykimin A.nr.1756/2021 të datës 19.05.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji i Këshillit, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se ankuesi me 15.07.2010 ka themeluar marrëdhënien punës në Autoritetin e Aviacionit Civil në pozitën e punës "Vozitës", ndërsa me Akte Emërimin e datës 15.07.2012 ankuesi është ngritur në pozitën "Asistent i Logjistikës" në Autoritetin e Aviacionit Civil, në kuadër të Administratës së Burimeve Njerëzore. Tutje, Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së me Vendimin Nr.ref.12/2010 të datës 19.10.2010 të njëjtin e ka caktuar që përveç detyrave funksionale që i ka sipas aktit të emërimit që të ushtroj edhe detyrat shtesë për pozitën e punës "Zyrtar për Pranimin e Mallit".

Ankuesi me datën 13.04.2016 me kërkesë i është drejtuar UD. Drejtorit të Departamentit për Administratë dhe Burimeve Njerëzore për ndryshimin e emërimit të pozitës dhe ngritje në pozitën nga Asistent i Logjistikes në pozitën "Zyrtar i Logjistikes" siç edhe ka përshkrimin e detyrave të punës, ndërsa kërkesa e njëjtë është përcjell tek Drejtori i Përgjithshëm i cili ka refuzuar kërkesën e ankuesit. Me datën 23.09.2016 ankuesi ka parashtruar kërkesë nen shenjën AACK/ADM/BNJ/28 te Komisionin për Zgjedhën e Kontesteve dhe Ankesave në Autoritetin e Aviacionit Civil, ndërsa Komisionin për Zgjedhën e Kontesteve dhe Ankesave në Autoritetin e Aviacionit Civil ndaj kërkesës së ankuesit të datës 23.09.2016 ka heshtur, mirëpo që ankuesi kundër heshtjes administrative asnjëherë nuk ka vazhduar tutje me procedurën ankimore pranë organeve përgjegjëse sikurse përcaktohej asaj kohe me dispozitat e ligjit material ndërlidhur me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Me datën 22.03.2021 ankuesi përsëri ka parashtruar kërkesë me numër protokollit 2021/ADM/98, ndërsa me datën 26.04.2021, Drejtori i Përgjithshëm i ACC-së i është përgjigjur kërkesës së ankuesit duke njoftuar se buxheti i ndarë për vitin 2021 në kategorinë e pagave dhe shtesave në ACC mbulon pozitën aktuale dhe se me këtë ndarje të buxhetit nuk është parapare ndonjë rritje e pagave apo avancim në pozita dhe se të gjitha kërkesat që kanë arritur në zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm që ndërlidhen me rritjen e pagave dhe ngritje në detyrë nuk mund të trajtohen.

Kolegji i Këshillit lidhur me shqyrtimin e themelësisë së pretendimeve ankimore ju referua nenit 9 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë (i aplikueshëm në kohën e parashtrimit të kërkesës) më të cilin parashihet se: *Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kantatës së punës, dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në provat e lëndës konstaton se ankuesi sipas Akt-it të Emërimit të datës 15.07.2012 mban pozitën e punës "Asistent i Logjistikës", dhe si rrjedhojë i njëjti realizon pagën e përcaktuar sipas këtij akt emërimi, fakt ky i cili nuk është kontestuar as nga vet ankuesi.*

Ndërsa sa i përket pretendimit lidhur me kompensimin e tij për ushtrimin e detyrave të caktuara përmes Vendimit Nr.ref.12/2010 të datës 19.10.2010 të Drejtori të Përgjithshëm të AAC-së, ku ankuesit i ishin caktuar detyrat shtesë për pozitën e "Zyrtarit për Pranimin e Mallit", Kolegji i Këshillit thekson faktin se sipas përmbajtjes së këtij vendimi në asnjë pjesë të tij qoftë në dispozitiv apo arsyetimin e tij nuk është përcaktuar që për punën e bërë ankuesi do të kompensohet, madje në kohën e nxjerrjes së këtij vendimi, në fuqi kane qenë të aplikuara dispozitat e Ligjit Nr.05/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku sipas nenit 29 të tij është përcaktuar si vijon: "Nëpunësve civilë mund t'u kërkohet që përkohësisht të kryejnë detyra, që janë jashtë funksioneve të tyre normale, nëse kjo është e domosdoshme për shkak të interesit të përgjithshëm" ndërsa ankuesi asnjëherë nuk e kishte kontestuar nxjerrjen e këtij vendimi, përkundër faktit mbi bazën e të njëjtë vendim me

datë 22.03.2021 ka kërkuar që t'i ndryshohet akt emërimi, gjegjësisht nga pozita "Asistent i Logjistikës" që e mbante sipas Akt-it të Emërimit të datës 15.07.2012, ka kërkuar t'i ndryshohet titulli i vendit të punës dhe t'i bëhet "Zyrtar i Pranimit/ Logjistikës". Ndërsa, në anën tjetër ankuesi me rastin e parashtrimit të ankesës nuk ka sjellë asnjë dëshmi nëse i njëjti këto detyra shtese i ka kryer jashtë orarit të rregullt të punës, në mënyrë që i njëjti të mund të kompensohej për punë jashtë orarit të rregullt siç përcaktohej me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë.

Lidhur me pretendimin ankimor për emërim në pozitën e Zyrtar i Pranimit/ Logjistikës, Kolegji i Këshillit thekson faktin se me dispozitat e nenit 38 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik përcaktohet qartë se lëvizja nga një pozitë në një pozitë tjetër në kuadër të shërbimit civil bëhet nëpërmes procedurës konkurruese, respektivisht pozita të cilën ankuesi e mban sipas aktit të emërimit dhe pozita në të cilën ankuesi kërkon të emërohet janë pozita në kuadër të kategorisë profesionale mirëpo ka dallime në klasa, prandaj sikurse u theksua më lartë një lëvizje e tillë bëhet vetëm nëpërmjet konkursit të cilin e zhvillon Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e institucionit punëdhënës me kushtin që pozitë të jetë e lirë dhe për të njëjtën institucioni duhet të ketë buxhet të miratuar sikurse përshkruhet edhe me dispozitat e Rregullores Nr.02/2020 Për Planifikimin e Personelit, nga rrjedh se shkresa e datës 26.04.2021 me shifër:2021/ZDP/143 e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës është në frymën e këtyre dispozitave ligjore të aplikuara në kohën e parashtrimit të kërkesës së ankuesit me datë 22.03.2021 tek Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, andaj mbi këtë bazë pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara ngase në shërbimin civil, lëvizja brenda kategorisë apo ngritja në detyra nuk mund të bëhet mbi bazën e kërkesave të nëpunësve civil, mirëpo vetëm sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 38 dhe 39 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Po ashtu lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për ngritje nga pozita "Asistent i Logjistikes" në pozitën "Zyrtar i Logjistikës", Kolegji i Këshillit ka analizuar edhe nenin 7 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë me të cilin është përcaktuar se: *1.Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitave në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat...*" dispozita këto të aplikuara në kohën e parashtrimit të kërkesës së ankuesit tek institucioni si dhe Ligjin Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi përkatësisht nenin 4 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji*, andaj, nisur nga kjo bazë ligjore dhe duke qenë së ankuesi realizon gradën e pagës sipas Akti të Emërimit, dhe për rrjedhojë nuk ka sjell dëshmi tjera që vërtetojnë të kundërtën, Kolegji nuk vëren rrethana të trajtimit jo të barabartë dhe diskriminues të ankuesit në raport me zyrtaret tjerë, kështu që mbi bazën e këtyre konstatimeve rrjedhë së janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit për ngritje në pozitë dhe kompensimin retroaktiv nga kur ka filluar te kryej detyra jashtë funksionit të tij të përcaktuara sipas vendimit Nr.ref.12/2010 të datës 19.10.2010 nga Drejtori të Përgjithshëm të AAC-së.


Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.392/2021

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Procesmbajtëse


Jeton Koca
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së,

